

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant për nevoja të Ujësjetës Kanalizime Sh.a Lezhë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134100-8 (Karburant Diesel)

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.163.600 (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e gjashtëqind) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Ujësjetës Kanalizime Sh.a Lezhë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga*

autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2.1. Kapacitetin profesional të operatoreve ekonomike::

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licencë për tregtim karburantesh të llojit III.1.A ose autorizim për leje tregtimi karburantesh të lëshuar nga njësi e qeverisjes vendore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar operatorët ekonomike duhet të paraqesin:

Përvojë e sukseshme në ekzekutimin e të paktën:

- a) Furnizime të kontratave të mëparshme, ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së prlogaritur të kontratës.
- b) Për të vertetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraesë vertetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, ..”*ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose*

entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar, vlera për furnizime të ngjashme prej **1.032.720 (një milion e tridhjetë e dymijë e shtatëqind e njëzet) leke**, përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këte menyre, AK ka sigurinë dhe besueshmerinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.2.2 Kopje të deklaratës së xhiros vjetore të 2 (dy) viteve të fundit, ku vlera mesatare e xhiros në të paktën njërin prej dy viteve të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve ekonomikë që ofrojnë këto lloje furnizimesh në tregun shqiptar, sasinë dhe cilësinë e mallit objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë dokumenta se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **2,065,440**

(dymilion e gjashtedhete e pesemije e katerqind e dyzet) leke , qe eshte vlera e fondit limit dhe vendosja e ketij limiti nuk kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Raport analizimi për tregun e brendëshëm, për cilësinë e gazoilit, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) .

2.3.2 Vërtetim nga ISHTI, që ofertuesi nuk ka marrë penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit , për vitin 2021.

Argumentimi: Pikat 2.3.1 dhe 2.3.2 janë vendosur në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 ” Për Prokurimin Publik”, nenit 40, pika 6, germa c, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 “Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”.

AK kërkon te garantohet qe karakteristikat teknike te mallit te ofertuar te perputhen me standartet teknike te kerkuara nga AK.

2.3.3 Ofertuesi duhet të deklarojë marrjen përsipër të furnizimit me karta elektronike sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Pika 2.3.4 është vendosur në analogji të Vendimit Nr. 561, datë 29.07.2016 ” Për Standartizimin dhe Disiplinimin e Shpenzimeve të Karburantit në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

2.3.4 Të ketë pikë furnizimi me karburant brënda qytetit të Lezhës (aktin e pronësisë për piken e furnizimit me karburant, të noterizuar).

2.3.6 Në rast se është me qira operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e qirase se noterizuar.

2.3.7 Në rast se ka kontratë bashkëpunimi operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e bashkëpunimit të noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentim

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr. 6, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, datë 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”, Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për lejet e Mjedisit”, të ndryshuar

Argumentim

Ky kriter është vendosur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor UK Sh.a Lezhë, duke qënë se furnizimi me karburant përfshin të gjitha automjetet e UK Sh.a Lezhë, duke filluar nga autoveturat deri tek makineritë e rënda apo stacionare dhe mjetet e rënda të cilat shërbejnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në të gjithë zonën e shërbimit të UK Sh.a Lezhë. Nisur nga kjo është parë si e domosdoshme dhe e nevojshme që furnizimi i tyre me karburant të realizohet nga një operator ekonomik, i cili të ketë pike furnizimi brenda qytetit të Lezhës, kriter ky i cili ul koston e rrugës vajtje – ardhje për automjetet e UK Sh.a Lezhë dhe rrit efikasitetin e shërbimit për automjetet, gjeneratorët e të gjitha mjetet e pajisjet e tjera të UK Sh.a Lezhë për të cilat do të përdoret karburanti objekt prokurimi.

Grafiku i lëvrimit

Lëvrimi i mallit do të ofrohet me karta elektronike dhe / ose tollona elektronike, nga data e nënshkrimit të kontratës deri në ezaurimin total të fondit limit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Hartimi i specifikimeve teknike të Gazoilit (Diesel 10 ppm) është bërë në përputhje me kërkesat që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” si dhe sipas Standardeve Shtetërore në fuqi që ato duhet të plotësojnë.

Specifikimet teknike janë vendosur në zbatim të Raport analizimit për tregun e brendshëm të Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial , Drejtorisë së Laboratorit Qëndror të Kontrollit, Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit në Republikën e Shqipërisë, sipas standarteve ndërkombëtare S SH EN 590:2017 dhe në funksion të furnizimit me naftë të mjeteve dhe automjeteve të UK Sh.a Lezhë.

Në realizimin e kontratës që do të lidhet me fituesin, në furnizimet që do të kryhen, çdo sasi gazoili duhet të shoqërohet me dokumentin Raport analizimi në tregun e brendshëm, të gazoilit, lëshuar nga Inspektoriatit Shtetëror Teknik , Drejtoria e Laboratorit Qëndror të Kontrollit, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre .

Hartoi: Njësia e Prokurimit

Flora Gjini

Bora Kolbuçaj

Aida Camaj